




QYTETARËT PËR TRANSPARENCË: LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT NË SEKTORIN SHËNDETËSOR SHQIPTAR

Nga data 26.12.2024, Shoqata "Together for Life", ka filluar zbatimin e projektit: "Qytetarët për Transparencë: Lufta kundër Korrupsionit në Sektorin Shëndetësor Shqiptar", me mbështetjen financiare të Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe Bashkimit Evropian.



Kohëzgjatja:

26.12.2024-25.11.2025 (12 muaj)

Shtrirja Gjeografike:

Kombëtare, me zbatim të veçantë të disa aktiviteteve në qytetet Elbasan, Berat, Shkodër

Qëllimi i projektit

- Rritja e transparencës dhe llogaridhënies në sektorin e kujdesit shëndetësor në Shqipëri përmes nxitjes së kulturës së raportimit të praktikave korruptive.



Rezultati i pritshëm Nr. 1 & Nr.2

- Të dhëna të besueshme të gjeneruara mbi perceptimet e publikut shqiptar për korrupsionin në sektorin e shëndetësisë.
- Rritja e ndërveprimit dhe dialogut midis palëve të interesuara kryesore mbi çështjet e korrupsionit që ndikojnë në sektorin e shëndetësisë.



Rezultati i pritshëm Nr. 3 & Nr.4

- Rritja e kuptimit mbi reagimin e institucioneve shëndetësore ndaj ankesave për korrupsion të drejtuar atyre, duke identifikuar boshllëqet dhe praktikat efektive.
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe angazhimit të publikut shqiptar në raportimin e praktikave korruptive në sektorin e shëndetësisë.



Rezultati i pritshëm Nr. 5 & Nr.6

- Rritja e vëmendjes së medias mbi korrupsionin në sektorin e shëndetësisë.
- Të paktën 10.000 qytetarë shqiptarë të kontaktuar përmes aktiviteteve të ndërgjegjësimit (online/personalisht).



AKTIVITETET KRYESORE

Zbatimi i këtij projekti në praktikë është i ndarë në tre grupime kryesore aktivitetesth



Cluster 1

- Vlerësimi i perceptimit publik dhe angazhimi me palët e interesuara: Vlerësimi i Perceptimit Publik;
- Tryezë e rrumbullakët me palët kryesore të interesuara për të diskutuar gjetjet e vlerësimit;
- Një njoftim për shtyp.



Cluster 2

- Monitorimi i reagimit antikorrupsion të institucioneve kryesore shëndetësore në vend: Një raport monitorimi mbi mënyrën se si institucionet e kujdesit shëndetësor trajtojnë ankesat që lidhen me korrupsionin.;
- Një tryezë e rrumbullakët për të prezantuar gjetjet e raportit.;
- Një njoftim për shtyp.;
- Pjesëmarrja në një seancë dëgjimore parlamentare.



Cluster 3

- Mobilizimi i qytetarëve për të raportuar korrupsionin në sektorin e kujdesit shëndetësor.;
- Promovimi i platformës Transparency.com.al si një mjet për raportimin e korrupsionit në sektorin e kujdesit shëndetësor.;
- Lançimi i një fushate në mediat sociale.;
- Prodhimi dhe shpërndarja e tre artikujve mediatikë mbi korrupsionin në sektorin e kujdesit shëndetësor.;
- Organizimi i forumeve të komunitetit në qytetet e Elbasanit, Beratit dhe Shkodrës.